

WELTLITERATUR: NGA NACIONALJA TE GLOBALJA

Ag APOLLONI

Më 31 janar 1827, Goethe i thotë Eckermann-it: *National literature is now rather an unmeaning term; the epoch of World literature is at hand, and every one must strive to hasten its approach*. Nuk e di çfarë ka ndodhur në vendet e tjera të bllokut komunist, por në botimin shqip (1987) të librit *Bisedat e Goethes*, ky konstatim profetizues është hequr, sepse flet kundër letërsisë kombëtare.

Njëzet vjet më vonë nga përmendja për herë të parë, termi *letërsi botërore* u përdor në Manifestin e Marksit dhe Engelsit, të cilët e politizuan termin, duke e përvetësuar si koncept komunist mbikombëtar. Natyrisht, ky ideologjizim synonte instrumentalizimin e letërsisë, pra vënien e letërsisë në shërbim të politikës, çka 100 vjet më vonë kulmoi me aplikimin e poetikës së përbashkët të letërsive të bllokut komunist: realizmin socialist. Kjo ishte linja e degradimit të termit: nga Goethe te Gorki.

Shtetet komuniste u uniformuan nëpërmjet poetikës aprioristike. Shtetet perëndimore e ruajtën termin vetëm sa për t'i manipuluar lexuesit. As shtetet komuniste, as shtetet kapitaliste, nuk ndihmuan në realizimin e ëndrrës së Goethes. Madje ato e kthyen termin e tij në një koncept të tmerrshëm. Letërsia botërore u pervertua nga komunizmi, duke u kthyer në letërsi skematike, ndërsa u abuzua nga kapitalizmi, që maskonte me atë term letërsinë e shteteve të forta perëndimore, duke përmendur vetëm shkarazi ndonjëherë edhe ndonjë autor të ndonjë letërsie të vogël. Përderisa Goethe e ëndërroi letërsinë botërore si letërsi antologjike, ideologët, studiuesit dhe profesorët e kthyen në term ideologjik dhe politik. Termi i krijuar është koncepti më human letrar, mirëpo termi i interpretuar është shpesh i keqkuptuar.

Megjithatë, nga ajo ditë e deri sot, koncepti letërsi botërore (*weltliteratur*) ka tërhequr vëmendjen e shumë studiuesve, kritikëve, profesorëve dhe shkrimtarëve. Nëpër universitetet e botës janë krijuar kurse dhe departamente me këtë emërtim. Në studimet letrare, janë krijuar metoda që hetojnë këtë çështje. Autorë të mëdhenj i janë kthyer këtij termi për ta qartësuar dhe për ta shtyrë përpara. Njëri nga ta, ndër më të mëdhenjtë e kohës sonë, Milan Kundera, i cili njihet për admirimin e madh ndaj Goethes, të cilin e ka portretizuar e sublimuar te romani *Pavdekësia*, në esenë me titull gjermanisht "Die Weltliteratur" thotë se ne e kemi tradhtuar testamentin e Goethes. Pse e thotë ai këtë? Sepse studiuesit dhe hartuesit e teksteve shkollore kujtojnë se duke i pranëvënë letërsinë nacionale në një libër, kanë krijuar historinë e letërsisë botërore. Pra, ajo çka kanë bërë historianët e letërsisë dhe autorët e teksteve shkollore, është krijimi i një konteksti të përgjithshëm të disa letërsive nacionale, ku natyrisht dominojnë, jo vetëm për arsye estetike, Anglia, Franca, Gjermania, Italia, Spanja, SHBA dhe Rusia.

Me të drejtë Kundera pyet: A do të ishte Franz Kafka kaq i njohur sikur të ishte çek? Dhe përgjigjet: *No, believe me, nobody would know Kafka today – nobody – if he had been a Czech.* Çekët edhe sikur ta botonin e ta promovonin, nuk do të kishin mundësi ta bënin të pranueshme në botë veprën ekstravagante të Kafkës, i cili jetoi në Pragë, por shkroi në gjuhën gjermane. E përderisa, siç thotë Heidegger, *gjuha është shtëpia e qenies*, Kafkën e shpëtoi streha e vet. Ai është botëror, sepse është gjerman, ndër gjermanët më të mirë, pa dyshim.

Tri përgjigje akademike

Dhjetë vjet më parë, në një intervistë për revistën *Symbol*, që e drejtoj unë bashkë me disa kolegë të mi, e pyeta studiuesen e njohur kanadeze, Linda Hutcheon: *Derisa letërsia krijohet nga personi, jo nga shteti, a mund të na e sqaroni pse rëndom kritikët eminentë preferojnë t'i studiojnë autorët e – më falni për termat ekonomikë- Botës së Parë, e pothuajse kurrë autorët e Botës së Dytë, apo të Tretë, madje edhe kur këta janë të përkthyer në anglisht. Është ky kriter i vlerës, apo diçka tjetër? Dhe ajo m'u përgjigj: "The power of national canons in the academy is still strong, as you note. But perhaps this focus on the canon is a sign of the perceived threat that your last question implied: a fear of universalization through globalization and thus a worry about losing national cultural integrity? I suspect it depends on the country and its academic culture, so there may not be any one single answer—but my guess is that none of the possible answers would involve*

matters of value or quality, but rather matters of ideology. In English-speaking countries, I do know, there has been in recent decades a move to study what would once have been considered non-canonical literature, especially that from the former colonies of Britain and America. "Post-colonial" studies is a very important area in North America, in particular, for it has opened up the serious examination of works from Africa, India, Sri Lanka, the Philippines, etc. And there are other reasons too, such as political/economic developments— things like the rise of China as a major world power—that have led to many more translations of (and therefore more study of) Chinese works in the west. The other change in North America, where I live and work, has been a move to what is called World Literature— closer to Goethe's idea—but usually restricted to what is available in translation. I've always seen this as a result of the demographics of North America: the increasing variety of peoples from all over the world now living in both the USA and Canada. But it clearly is also a move away from the study of only canonical First World writers, and a healthy one, I believe."

Nga kjo përgjigje e Hutcheon-it, ne e kuptojmë që termi letërsi botërore nuk është indiferent ndaj zhvillimeve ekonomike dhe politike, dhe që lëvizjet demografike imponojnë shkëmbimet kulturore, të cilat e pasurojnë letërsinë botërore.

Një pyetje në lidhje me këtë çështje ia kam bërë edhe profesorit amerikan, Jonathan Culler: *Sa ndihmon letërsia krahasuese në studimin e letërsisë së vendeve të vogla dhe sa ndihmon në njohjen e tyre? Çfarë mendoni për letërsinë e krijuar në Ballkan? Ai më është përgjigjur: "There are of course comparatists who study the literature of small countries and that may help them become better known. On the other hand, since comparatists also are drawn to the most important literatures, they may neglect the literatures of small countries, which has certainly been the case with me. There is so much English, French, German, and Italian that I haven't been tempted to look elsewhere, especially with languages I don't know. I'm afraid I have no knowledge of the literatures of the Balkans."*

Përgjigjja e prof. Culler-it më pëlqen, sepse është e sinqertë, pa pasur nevojë të jetë e tillë. Ai shumë lehtë mund të hynte në google, të nxirrte disa emra nga letërsia e Ballkanit, dhe të më jepte një përgjigje false, sa për t'u dukur që e njeh edhe letërsinë e kësaj ane. Mirëpo, ai është studiues i madh, sepse flet vetëm për ato që i di. Dhe ai e pranon që s'e njeh letërsinë e Ballkanit. E kam fjalën për letërsinë moderne, jo për atë antike. Megjithatë, ky është një shqetësim për shkencën e studimeve letrare. Kur nuk e njeh ai këtë letërsi, merreni me mend sa mund ta njohin lexuesit e thjeshtë. E, Ballkani përfshin edhe Greqinë, e cila gjatë shekullit 20 ka nxjerrë njërin nga poetët më të mirë modernë, i denjë për t'i prirë plejadës së modernistëve botërorë, Kostandin Kavafis, pastaj dy nobelistët Giorgos Seferis dhe Odiseas Elytis, e mbi të gjitha ka nxjerrë shkrimtarin Nikos Kazantzakis, këtë Homer modern. Përveç Greqisë, kemi edhe Rumaninë: Mircea Eliade, Nichita Stanesco, Marin Sorescu etj., figura që i bëjnë nder letërsisë botërore; Kroacinë, e cila, përveç disa shkrimtarëve të shkëlqyeshëm të ditëve të sotme, ka dhënë edhe Miroslav Kërležhën, i cili ka meritën që, si kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Jugosllavisë dhe mik i Titos, arriti ta kundërshtonte metodën e realizmit socialist, duke e lënë vetëm si metodë opsionale, jo obligative.

Gjithashtu, në Ballkan janë edhe Ivo Andriq, Mesha Selimoviq e Danillo Kish, i cili është lavdëruar aq shumë nga Kundera, Roth, Brodsky, Sontag etj. Po ashtu, në Ballkan janë edhe sllovenët Boris Pahor e Drago Jançar, e po ashtu (duke shpresuar që kjo nuk paraqet konflikt interesi), bashkëkombësi im i famshëm, Ismail Kadare. Ka edhe shkrimtarë të tjerë që meritojnë të njihen e të jenë pjesë e kanonit të letërsisë botërore, nëse ky term sinjifikon një kanon. Goethe propozon që model për letërsinë botërore të merret letërsia greke. Letërsia botërore e ka vendlindjen në Ballkan, prandaj s'e kuptoj kompleksin perëndimor për të ikur nga Itaka.

Në pyetjen time se a ka kuptim sot termi "letërsi botërore" kur dihet se pjesa më e madhe e letërsisë së botës nuk përfshihet në të?, profesori dhe studiuesi Hans Bertens, më ka dhënë këtë përgjigje: "World literature" in the sense in which it is used in American universities (and more and more elsewhere) refers to that literature which circulates, with a certain permanence, beyond its culture of origin. So it is certainly true that most literature does not qualify as "world literature." It is a concept that clearly puts "small" literatures at disadvantage, since translation into one or more other, preferably major, languages is an absolute condition. In practice, it is writers in English who profit most from this particular definition of "world literature" since far more fiction is translated from English into other languages than the other way around (last year only ten translations from the French appeared in English, and some of them were new translations of French classics). On the other hand, the large majority of novels published in English do not get translated either, so it is certainly not the case that all English-language literature qualifies as "world literature." But the deck is absolutely stacked against writers who write in a "small" language.

Siç mund ta shihni edhe nga pyetjet, unë termin letërsi botërore e kam përdorur edhe në kuptimin e një koncepti integruar të letërsive "të vogla", në mënyrë që të zgjerohet harta. Përderisa *weltliteratur* s'mund të kthehet kurrë në një nocion tipologjik, atij gjithmonë do t'i japim attribute gjeografike dhe aksiologjike. Goethe i nënkuptonte të dyjat. Donte t'i njëhte letërsitë e vendeve të tjera, dhe t'i afronte vlerat e letërsive të tjera. Pra, së pari t'i njohim *vendet* (kontekstin), pastaj edhe *vlerën* (tekstin). Zgjerimi i hartës është i domosdoshëm. Si bëhet sot ky zgjerim? Duke u përkthyer. Ajo çka thotë Bertensi, duke theksuar një fakt statistikor, flet më shumë për një qëndrim ekskluziv që nuk duhet të duartrokitet.

Letërsia botërore dhe gjuha botërore

Nga mitologjia biblike e dimë që të gjithë njerëzit flisnin një gjuhë, deri kur nisën kullën e Babelit, dhe Zoti ua përzjeu gjuhët. Kështu nisi epoka pas Babel, nga e cila ende nuk kemi dalë.

Ndërsa, nga të dhënat arkeologjike e dimë që tekstet e para u shkruan në tri kontinentet e vjetra: Azia, Afrika dhe Evropa. Mesopotamia, Egjipti dhe Greqia janë tri shtyllat e qytetërimit botëror, edhe pse asnjëra nga këto qendra nuk fliste një *gjuhë botërore*. Anglishtja që sot njihet si gjuhë botërore, nuk ekzistonte, ndërsa vendi i saj (Anglia) nuk ishte pjesë e kontinentit tonë, dhe dy kontinentet e tjera anglofone (Amerika Veriore dhe Australia) nuk njiheshin fare. Sot, sipas një konsensusi akademik, anglishtja është gjuhë botërore.

Kjo nuk do të duhej të ishte shqetësuese për askënd. Shqetësuese është tendenca akademike dhe politikat editoriale për t'i promovuar si letërsi botërore vetëm ato vepra që qarkullojnë në këtë gjuhë botërore. Pra, sipas këtij koncepti, për të qenë një vepër e një niveli botëror duhet të jetë e botuar në gjuhën botërore. Natyrisht, as për ata që e marrin gjuhën si determinante kryesore, nuk do të thotë se çdo vepër e shkruar anglisht ose e përkthyer anglisht, mund të konsiderohet vepër botërore.

Por në shekullin tonë është një disponim dominant, që mund të kthehet në konsensus: një vepër për të qenë e denjë për letërsi botërore duhet të jetë shkruar ose botuar në gjuhën botërore. Pra, gjuha e përcakton fatin e letërsisë.

Sigurisht, konceptit të Goethes është duke i shërbyer shkëlqyeshëm edhe komparatistika, duke ballafaquar letërsi të ndryshme dhe duke zbuluar autorë që nuk janë njohur, por që meritojnë të njihen botërisht.

Studimet komparative marrin parasysh edhe veprat në gjuhë të vogla. Meqë shumica e studimeve të tilla botohen anglisht, ndihmojnë në promovimin e tyre në një gjuhë të madhe. Komparatistët e bëjnë të njohur një relacion mes veprave të ndryshme nacionale për ta kthyer ngjashmërinë në vlerë globale. Pra, from national to global.

Dined with Goethe. "Within the last few days, since I saw you," said he, "I have read many and various things; especially a Chinese novel, which occupies me still, and seems to me very remarkable."

"Chinese novel!" said I; "that must look strange enough."

"Not so much as you might think," said Goethe; "the Chinamen think, act, and feel almost exactly like us; and we soon find that we are perfectly like them."

Pra, ne duhet ta njohim letërsinë e tjetrit, jo vetëm tonën, dhe këtë e bën edhe komparatistika, kjo shërbëto e letërsisë botërore. Më parë, ajo çka konsiderohej letërsi botërore ishte kryesisht klasikë evropiane, plus ndonjë tekst i lashtë afrikan e aziatik. Mirëpo, siç sugjeron profesori i Letërsisë Botërore në Universitetin e Harvardit, David Damrosch, tashmë ka ndodhur një kalim *from Old world to Whole world*. Për klasiken kemi mirëkuptim, por problemi është bashkëkohorja. Të gjithë e dinë që Shakespeare i përket letërsisë botërore, por ende nuk ka një konsensus të tillë për Julian Barnes, për shembull.

Tash mund të pyesim se çka është letërsia botërore:

term tipologjik (po ulem e po e shkruaj një vepër që do të jetë letërsi botërore)?

term aksiologjik (kjo vepër është shumë e mirë sa meriton të njihet në gjithë botën)?

term gjeografik (kjo vepër vjen nga ky vend dhe lexohet nëpër shumë vende të botës, prandaj është vepër botërore)?

Nga biseda e Goethes kuptohet që ky term nënkupton *vendin* dhe *vlerën*. Le ta njohim një *vlerë* që vjen nga një *vend* tjetër. Ky koncept është së pari *inkluziv*, pastaj *kognitiv*, dhe së treti *selektiv*. Çka mbetet nga përzgjedhja është e denjë për t'u konsideruar letërsi botërore. Së pari, duhet të ketë përfshirje globale, pastaj përzgjedhje nacionale, për të dalë te kryeveprat mbinacionale.

Pra, *procesi* për të ardhë te letërsia botërore duhet të shtrihet në krejt letërsitë e botës, por letërsia botërore si *rezultat* përfshin veprat më të mira të botës. Letërsia botërore nuk është histori e letërsive, por letërsia e letërsive, *crème de la crème*.

Ne jemi në një fazë kur më shumë na duhet njohja, sesa vlerësimi. Ne kemi nevojë të lexojmë njëri-tjetrin. Ne kemi nevojë ta njohim njëri-tjetrin. Ne kemi nevojë ta njohim hartën e weltliteratur-es. Lexuesi perëndimor ka njohuri modeste mbi letërsitë aziatike, dhe njohuri minimale mbi letërsitë afrikane. Njohuri të përcipta ka edhe mbi letërsitë *e vogla* të Evropës, si ajo çeke dhe shqiptare. Ata i harrojnë, sepse janë në qendër, ne na harrojnë sepse jemi në qoshe. Megjithatë, shkrimtarët e mirë, ata vërtet të talentuar, mund të shprejnë se herët a vonë, do të jenë pjesë e letërsisë botërore.

Literatura:

- [1]. Bertens, Hans. *Farewell to postmodernism*. Pristina: Symbol, No 17, 2019.
- [2]. Culler, Jonathan. *A Life in Criticism*. Pristina: Symbol, No 11, 2017.
- [3]. Damrosch, David. *What is World Literature*. Princeton University Press, 2003.
- [4]. Damrosch, David. *How to read World Literature*, New Jersey: Wiley-Blackwell, 2009.
- [5]. Hutcheon, Linda. *Beyond postmodernism*. Pristina: Symbol, No 1, 2013.
- [6]. Eckermann, Johann Peter. *Conversations of Goethe*. Digital Production by [HTTP://WWW.HXA7241.ORG/](http://www.hxa7241.org/), 2010.
- [7]. Kundera, Milan. *The Curtain*, London: Faber and Faber, 2007.